



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government




Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

Fakulteti i Sigurisë Publike

PLANI PËR ZHVILLIMIN E PERSONELIT

AKADEMIK-FSP 2024-2026



Dhjetor, 2023

Përmbajtja:

HYRJE	3
VIZIONI DHE VLERAT	4
FUSHAT E PËRGJEGJËSISË	5
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	7
MONITORIMI DHE VLERËSIMI	10
PLANI I VEPRIMIT	11



Fakulteti i Sigurisë Publike - FSP

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion i formuar me Ligjin Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (më tutje Akademia), përgjegjës për ofrimin e arsimit të lartë për zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Akademia ofron trajnime dhe arsim të lartë për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në:

- ✓ Policinë e Kosovës;
- ✓ Shërbimin Korrektues;
- ✓ Shërbimin Sprovues;
- ✓ Doganën e Kosovës;
- ✓ Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;
- ✓ Inspektoratin Policor të Kosovës.

Me qëllim të realizimit të mandatit të saj ligjor në fushën e arsimit të lartë, krahas aprovimit të Ligjit të AKSP-së në dhjetor të vitit 2011, Komisioni Evropian ka aprovuar dhe financuar Projektin e Binjakëzimit me titull: ***“Përmirësimi i arsimit në sektorët e sigurisë dhe rendit publik”*** i cili është implementuar gjatë periudhës 2012 – 2014 nga shtetet implementuese Finlanda dhe Estonia ku si rezultat i këtij projekti u bë e mundur themelimi dhe funksionalizimi i Fakultetit të Sigurisë Publike përmes të cilit ofrohen programe studimore në fushën e sigurisë publike për të gjithë zbatuesit e ligjit, në përputhje me procesin e Bolonjes, përkatësisht me standardet evropiane, diçka që më parë nuk kishte ekzistuar jo vetëm në Akademi, por as në Kosovë dhe në Regjion.

Plani për zhvillimin e personelit akademik, është dokument që personelit akademik i siguron kushte modeste për zhvillim, avancim dhe promovim akademik. Zbatimi i plotë i këtij plani, stimulon personelin për tu marrë me veprimtari kërkimore shkencore, duke publikuar në revista shkencore ndërkombëtare, për të marrë pjesë në konferenca shkencore, vizita studimore për të arritur gradat shkencore dhe titujt akademik, si dhe përgatitjen e botimeve për të pasuruar krijimtarinë shkencore dhe për të mbuluar fushat studimore në kuadër të fushave ku nuk ka literaturë të mjaftueshme.

Plani për zhvillimin e personelit akademik i dedikohet personelit akademik, me qëllim të zhvillimit dhe avancimit të mësimdhënësve në pjesën hulumtuese dhe pedagogjike, që programeve të studimit ti sigurohet funksionim cilësor akademik.

Plani për zhvillimin akademik është plan i detajuar i masave dhe i aktiviteteve, i cili u ndihmon anëtarëve të stafit të universitetit që të zhvillohen profesionalisht dhe të përmirësojnë cilësinë e punës së tyre. Ai krijon mundësi të barabarta për gjithë stafin akademik dhe i përfshin të gjitha kategoritë e tij.

Plani për zhvillimin e personelit akademik mbështetet në këto objektiva strategjike, të zërthyer në objektiva specifike, si dhe aktivitetet për arritjen e tyre.



OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

**Zhvillimi dhe
avancimi
personelit
akademik**

**Mbështetja e
personelit
akademik në
hulumtime
shkencore**

**Mbështetja e
personelit
akademik në
botimin e
publikimeve**

Fakulteti i Sigurisë publike-FSP e trajton stafin akademik si njërin ndër burimet themelore të tij. Ai është i përkushtuar që t'i ndihmojë secilit anëtar të stafit që të zhvillohet profesionalisht gjatë punës së tij në këtë Fakultet sepse është i përkushtuar që t'u mundësojë atyre zhvillim të vazhdueshëm profesional, duke e ditur se përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij zhvillimi janë studentet tanë, si dhe shoqëria në përgjithësi.

Fakulteti synon t'i identifikojë dhe të njohë në vazhdimësi nevojat e stafit për zhvillim profesional dhe t'u mundësojë atyre zhvillim të vazhdueshëm, në mënyrë që investimi në këtë fushë të sjellë përfitime për studentet dhe shoqërinë.

Vizioni i FSP-së

Fakulteti i Sigurisë Publike përmes standardeve akredituese synon të shndërrohet në qendër të rëndësishme të hulumtimit, zhvillimit akademik, edukimit cilësor të studentëve duke kontribuar në ofrimin e një ambienti të sigurtë për gjithë shoqërinë.

Vlerat

- ❖ Përsosmëria dhe inovacioni,
- ❖ Etika dhe integriteti akademik,
- ❖ Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi



FUSHAT E PËRGJEGJËSISË

- **Mirëseardhja e stafit të ri akademik** - Mirëseardhja siguron që stafi i ri i rekrutuar -angazhuar në FSP të marrë informacionet e nevojshme në mënyrë që të jenë anëtarë produktive të ekipit FSP zhvillon takim orientues për stafin e ri akademik me qëllim që tu tregohen politikat thelbësore të punonjësve dhe trajnimet e domosdoshme. Orientimi behet menjëherë para fillimit të semestrit në mënyrë që t'i marrin informacionet e mjaftueshme. FSP ofron trajnime të përshtatshme për sistemet elektronike, politiken dhe procedurat e fakultetit, konkretisht detyrat e tyre të punës. I gjithë stafi i ri duhet të marrë pjesë në seancën e mirëseardhjes në javën e parë të tyre. Gjate kësaj seance organizohet një vizite në kampus në mënyrë që të prezantohen me koleget dhe studentet. FSP do të zhvillojë një program për mirëseardhje në mënyrë të sigurohet një mekanizëm me i lehtë për të krijuar mjetet e duhura para ditës së parë të punës për stafin e ri.
- **Ngritja e numrit të stafit akademik** - FSP synon në vazhdimësi avancimin dhe rritjen e numrit të stafit akademik dhe do të vazhdojë ta bëjë në vitet e ardhshme duke pranuar staf të ri akademik, rritur numrin e stafit të avancuar në thirrjet akademike Profesor Asistent, Professor i Asociuar, Profesor i Rregullt, dhe Emeritus, që do të kontribuojnë në mbulueshmërinë e programit bachelor si edhe në avancimin e krijimit dhe ofrimit të programeve shkencore të masterit. FSP në bashkëpunim me AKSP do të ndërmarrë veprime për rritjen e numrit të stafit akademik me grade shkencore doktor i shkencave për mbulueshmërinë e programeve të ofruara.
- **Vlerësimi i stafit akademik** - Procesi i vlerësimit të performancës së stafit akademik të FSP-së ofron mundësi të konsiderueshme për stafin për të arritur qëllime personale dhe profesionale të cilat janë në përputhje me planet strategjike dhe operacionale të njësisë akademike. Ky proces mbështet krijimin e një kulture të vazhdueshme të mësimi dhe përmirësimit të performancës në të gjithë Fakultetin dhe është kontribut thelbësor në promovimin e stafit akademik në veçanti. FSP do të ndërmarrë veprime duke krijuar mekanizma funksionale për matjen e performancës akademike, Trajnimi i stafit akademik në hartimin e planeve individuale zhvillimore.
- **Përgjegjësit individuale** - Stafi akademik është përgjegjës para se gjithash për hartimin me kujdes të Planit Individual për Zhvillim Akademik si dhe të sigurojë se aktivitetet e parapara dhe të miratuara nga ky plan do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së tyre akademike dhe zhvillimin në karriere në mënyrë efikase. Anëtarët e stafit akademik duhet të reflektojnë vazhdimisht për të arriturat e tyre, ta rishikojnë atë, të propozojnë ndryshime e plotësime, në mënyrë që të sigurohen se synimet e tyre për zhvillim akademik të arrihen. Qëllimi i zhvillimit akademik të stafit është që t'i sigurojë çdo anëtar të stafit mundësinë për të analizuar nevojat e tij të zhvillimit, të vendosë qëllime specifike afatshkurtra dhe afatgjata, dhe të vendosë se cilat mundësi i plotësojnë me mire ato nevoja dhe qëllime. Dekani duhet të monitorojë progresin që stafi është duke bërë drejt qëllimeve të tij.
- **Identifikimi i Nevojave të zhvillimit Akademik** - Mbikëqyrësit dhe stafi duhet të përdorin vlerësimin vjetor të performancës për të shqyrtuar arritjet e mëparshme, aftësitë dhe për të identifikuar nevojat e trajnimit. Në kohën e vlerësimit, mbikëqyrësi dhe punonjësi vendosin qëllime për vitin e ardhshëm. Qëllimet do të jenë të lidhura me punën, sit janë rritja e niveleve të shërbimit, ose qëllimet mund të hartohen për të përmirësuar aftësitë ose arsimimin e punonjësve dhe për të sfiduar punonjësit për hapin tjetër në karrierën e tyre. Kompetenca

ndërkulturore e te punësuarve dhe mënyra se si te përmirësohet me kompetencën ndërkulturore duhet te diskutohet dhe përfshihet ne procesin e vlerësimit.

FSP do te monitoroje progresin analizojnë nivelet e aftësive te stafit për te përcaktuar se ku janë te nevojshme përmirësimet për te vazhduar te jetë një institucion inovativ në mësimdhënie.

- **Përmirësimi i cilësisë se mësimdhënies** - Avancimi ne mësimdhënie dhe mësim nxënie është prioritet dhe mund te arrihet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit te këtij komuniteti. FSP është po ashtu një qendër e mësimit gjate gjithë jetës për stafin e tij, duke ofruar kushte qe mundësojnë avancimin e kapaciteteve te tyre pedagogjike me studentin ne qendër të vëmendjes. Për t'u siguruar qe mësimdhënia dhe te mësuarit e studenteve janë te një cilësie te larte, FSP është e përkushtuar qe te krijojë një sistem te strukturuar te identifikimit të nevojave për zhvillim akademik te secilit stafit akademik, si dhe te monitoroje adresimin e tyre.

FSP do te ndërmarrë veprime duke Trajnuar stafin akademik për hartimin dhe rishikimin e syllabuseve konformë Kornizës Kombëtare te Kualifikimeve.

- **Hulumtimet** - Krahas mësimdhënies ne Fakultet, realizohen edhe projekte hulumtuese nga stafi dhe studentet. Ne kuadër të programit studimor është e obliguar puna praktike dhe hulumtuese si dhe përgatitja e temave te diplomës ne nivelin përkatës te studimeve. Metodologjia e hulumtimeve është specifike për secilën fushe hulumtuese dhe ne përputhje me standardet e aplikueshme dhe te pranueshme me nivelin ndërkombëtar. Përgatitja e rezultateve, përpunimi, interpretimi dhe publikimi i tyre behet sipas standardeve te paracaktuara sipas metodës se hulumtimit. Fakulteti do te ndërtojë kapacitete dhe aftësi, duke motivuar dhe angazhuar stafin përmes ofrimit te sesioneve ne lidhje me praktiken shkencore, projekteve për te përmirësuar dhe zhvilluar praktiken akademike.

- **Publikimet ne revista te indeksuara ne databaza kredibile** - Sipas akteve në fuqi për secilën thirrje akademike kërkohet një numër i caktuar i artikujve shkencor, kështu qe stafi i FSP inkurajohet qe publikimet e tyre te i realizojë ne revista te indeksuara kredibile ndërkombëtare te indeksuara ne data baza siç janë; WEB OF SCIENCES, SCOPUS, EBSCO dhe DOAJ. Me qellim te mbajtjes se stafit akademik te njoftuar me përditësimet nga këto revista si dhe mënyrën e qasjes ne këto revista, FSP do të organizon sesione informuese te rregullta vjetore, si dhe individuale sipas kërkesës, për stafin akademik. AKSP brenda vitit do te përkrahë financiarisht stafin akademik për pjesëmarrje ne konferenca ndërkombëtare dhe publikim te punimeve shkencore.

- **Promovimi i inovacionit** - FSP ne politikat e saj promovon ne vazhdimësi inovacion në procesin e mësimdhënies dhe mësim- nxënies, dhe për këtë qellim inkurajon bashkëpunimin ndërmjet stafit akademik në mënyrë qe te krijohen programe studimi inovative ne te gjitha nivelet e studimit. Kjo për fakti se pjesëmarrja ne proceset e reja e inovacionit kërkon aftësi dhe shkathtësi qe mundësojnë shkëmbimin, pranimin, dhe bashkë krijimin në bazë të besimit dhe bashkëpunimit. Inovacioni në mësimdhënie dhe mësim nxënie është i mundur edhe nëpërmjet bashkëpunimit te ngushte mes komunitetit akademik me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare.



Objektivi strategjik 1 - OBJEKTIVI STRATEGJIK: ZHVILLIMI DHE AVANCIMI I PERSONELIT AKADEMIK

Objektivi specifik 1.1 - Personel i ri cilësor që do të zhvillohet për nevojat e fakultetit



AKTIVITETET

1.1.1. Ashtu siç parashihet me Rregulloren e AKSP-se për arsimin e larte FSP do të krijoj mundësi të barabarta gjatë rekrutimit të personelit të ri akademik, duke siguruar dhe mbështetë barazinë gjinore dhe duke promovuar dhe krijuar mundësi të ngritjes së pjesëmarrjes së gjinisë femërore në përbërjen e personelit akademik.

1.1.2. Personelit akademik do t'i ofrohet mundësi e plotë që ti kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e veta nga mësimdhënia, hulumtimi, mobiliteti etj.

1.1.3. Do të sigurohet dhe promovohet liria akademike, si një e drejtë themelore kushtetuese e garantuar.

1.1.4. Do të sigurohet vazhdimisht personel akademik i kualifikuar sipas fushës përkatëse për programet mësimore që ofrohen në kuadër të fakulteteve, duke përfshirë këtu edhe fushat e ngushta profesionale.

1.1.5. Do të krijohen kushte dhe përkrahje institucionale për avancim dhe kualifikim të personelit akademik të ri për hulumtim dhe mësimdhënie cilësore. Do të sigurohen shërbime cilësore dhe mbështetje administrative efikase.

Objektivi specifik 1.2. - Përtëritja dhe kualifikimi i personelit akademik



AKTIVITETET

1.2.1. Me qëllim të arritjes të kualifikimeve përkatëse, personeli akademik do të përkrahët në realizimin e mobilitetit shkencor pranë universiteteve ndërkombëtare, ose ndonjë formë tjetër e stimulimit, në mënyrë që ata të merren me punë kërkimore-shkencore.

1.2.2. Do të zhvillohen procedura që rrisin cilësinë dhe kapacitetet për realizimin e punës kërkimore shkencore. Këto procedura do të përcaktojnë fushat me interes për realizimin e mobilitetit shkencorë, krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit ndërkombëtar në projekte dhe publikime, përkrahjen materiale si dhe promovimin në zhvillimin e mëtutjeshëm të imazhit të AKSP-se. Do të mbështeten mobilitetet e mundshme të personelit mësimdhënës, për qëndrime semestrale ose vjetore me qëllim të ngritjes së tyre shkencore dhe profesionale.

Objektivi specifik 1.3. - Aftësimi i vazhdueshëm i personelit akademik në fushën e metodologjisë së mësimdhënies



AKTIVITETET

1.3.1. FSP do të krijoj kushte që grupe të mësimdhënësve dhe shërbimit studentor të dërgoj jashtë vendit për ngritje profesionale dhe për çështje bashkëkohore të metodologjisë së mësimdhënies.

1.3.2. FSP do të krijoj kushte që të organizoj trajnime duke angazhuar ekspertë nga jashtë. Ky aktivitet do t'i përfshinte kryesisht mësimdhënësit.

1.3.3. Çdo vit do të mundësohet dhe përkrahet personeli akademik të vijojë programet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Qendrës për përsosmëri në mësimdhënie të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në kuadër të marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet dy universiteteve. Këto programe dhe trajnime kanë për qëllim zhvillimin e njohurive dhe praktikave të reja të mësimdhënies.

Objektivi specifik 1.4. - Pjesëmarrja e rregullt e personelit akademik në konferenca, seminare, simpoziume apo tubime tjera shkencore ndërkombëtare



1.4.1. Do të mbështetet personeli akademik për pjesëmarrje në konferenca, seminare, simpoziume apo tubime tjera shkencore ndërkombëtare.

1.4.2. Personeli akademik do të përkrahet dhe stimulohet që vazhdimisht të paraqitet në konferenca dhe simpoziume shkencore, qofshin ato ndërkombëtare, rajonale, apo nacionale, ku do të paraqiten prezantimet shkencore.

1.4.3. Për qëllim të pjesëmarrjes në konferenca ose simpoziume shkencore, në kuadër të mundësive buxhetore, personeli akademik do të mbështetet materialisht.

Objektivi specifik 1.5. - Përkrahja e vazhdueshme e personelit akademik për avancim akademik



1.5.1. FSP, do të përkrahë personelin akademik që e ka gradën shkencore Master, për avancim akademik për të arritur gradën PhD.

1.5.2. FSP, do të përkrahë personelin akademik për avancim akademik në thirrje akademike

1.5.2. Do të krijohen kushte për mobilitete afatshkurtra, përfshirë këtu vizitat studimore në institucione akademike dhe hulumtuese ndërkombëtare.

Objektivi strategjik 2 -MBËSHTETJA E PERSONELIT AKADEMIK NË HULUMTIME SHKENCORE

Objektivi specifik 2.1 - Zhvillimi më i theksuar i hulumtimit shkencor në proporcion me mësimdhënien



2.1.1. Krijimi i kushteve për angazhimin e personelit akademik të FSP-se në mësimdhënie dhe veprimtari kërkimore shkencore bazuar në praktikën më të mira evropiane.

2.1.2. Krijimi i mundësive për botimin e punimeve shkencore të personelit mësimdhënës në revista me recension ndërkombëtar.

2.1.3. Personeli akademik duhet të aftësohet për të hartuar projekte të bashkëpunimit për hulumtim dhe bashkëpunim me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë.

2.1.4. Do të rritet bashkëpunimi institucional ndërkombëtar në fushën e kërkimeve shkencore.

2.1.5. Do të krijohet mundësi për qasje më të gjerë të personelit akademik dhe të studentëve në burime elektronike, me qëllim të përcjelljes së zhvillimeve më të reja shkencore.

Objektivi specifik 2.2 - Përkrahja e personelit akademik për të publikuar në revista me recension ndërkombëtar



AKTIVITETET

2.2.1 Personeli akademik vazhdimisht do të përkrahet, në mënyrë që ata t'i publikojnë punimet e tyre shkencore në revista shkencore, në pajtim me platformat e miratuara nga MASHT – i, dhe Këshilli i FSP-se.

2.2.2. Personeli akademik do të mbështeten në inicimin e ideve të tyre për publikime cilësore në revista shkencore.

Objektivi specifik 2.3 - Sigurimi i qasjes në revista shkencore elektronike dhe organizata shkencore ndërkombëtare



AKTIVITETET

2.3.1. Do të mundësohet parapagimi në pako elektronike ndërkombëtare shkencore, për t'i ndihmuar personelit akademik rritje të numrit të publikimeve në revista ndërkombëtare.

2.3.2. Do të përkrahet anëtarësimi dhe do të parapaguhet kërkesat eventuale financiare për qasje në asociacionet, rrjetet e bashkëpunimit, institutet dhe organizatat e tjera shkencore ndërkombëtare, ku stafi akademik do të mund të përfitojë nga mundësitë që ofrojnë këto organizata.

Objektivi specifik 2.4 - Përkrahja dhe motivimi i personelit akademik për inicim dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare



AKTIVITETET

2.4.1. Do të mundësohet pjesëmarrja e personelit akademik në trajnime dhe seminare të ndryshme me qëllim të aftësimit të tyre në hartimin e projekteve dhe të propozimeve për pjesëmarrje në programet e ndryshme kërkimore të BE – së dhe në krijimin e lidhjeve me institucionet kërkimore ndërkombëtare.

2.4.2. Organizimi i punëtorive me qëllim që t'u ndihmojë personelit akademik që sa më lehtë dhe në mënyrë efikase të ndërlidhen me projektet e ofruara ndërkombëtare për bashkëpunim.

2.4.3. Nëse ndonjë nga këto projekte implementohet në partneritet me institucione të tjera, FSP do të bëjë përpjekje maksimale për të ofruar kushte optimale për zhvillim të bashkëpunimit.

Objektivi specifik 2.5 - Organizimi i konferencave dhe tryezave shkencore



AKTIVITETET

2.5.1. Do të mbështeten dhe inkurajohen organizimet e konferencave shkencore ku organizator, apo bashkë organizatorë do të jetë FSP.

Objektivi strategjik 3 -MBËSHTETJA E PERSONELIT AKADEMIK NË HULUMTIME SHKENCORE

Objektivi specifik 3.1 - Mbështetja publikimeve

 AKTIVITETET	3.1.1. Do të mbështeten botimet e teksteve, praktikumeve, përmbledhjeve të punimeve dhe teksteve të tjera, të cilat përmbajnë arritjet profesionale apo shkencore nga personeli akademik. 3.1.2. Përparësi botimi kanë publikimet origjinale, sidomos për lëndët mësimore që nuk kanë tekst bazë universitar dhe publikimet të cilat me plane dhe programe mësimore janë literaturë e domosdoshme për studentë. 3.1.3. Publikimet e botuara do të shfrytëzohen për nevoja të studentëve, personelit dhe komunitetit të gjerë shkencorë. 3.1.4. Kushtet dhe procedurat për dorëzimin e dorëshkrimit, mbështetjen financiare dhe aspektet e tjera, do të përcaktohen me rregullare nga Këshilli FSP.
--	--

MONITORIMI

VLERËSIMI

Plani zhvillimor i Fakultetit do të monitorohet në mënyrë periodike për të përcjellë zbatimin e tij, por edhe do t'i nënshtrohet vlerësimit objektiv për të parë nëse janë arritur objektivat e planifikuara, nëse ka pasur ndikim dhe nëse ndryshimet janë të qëndrueshme.

Plani zhvillimor do të zbatohet bazuar në planet vjetore të veprimit, ku do të përcaktohen caqet specifike dhe të matshme, të cila mundësojnë edhe monitorimin e parvjetshëm të arritjes së rezultateve dhe aktiviteteve të planifikuara. Monitorimi në baza vjetore do të përcaktojë nëse ka indikacione se produktet po ndikojnë në arritjen e objektivave, për të përcaktuar nevojën e ndryshimeve eventuale të ndonjë aspekti të planifikuar që mund të dalë nga analiza e raporteve, statistikave dhe monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të aktiviteteve dhe matjes së treguesve.

Përcaktimi kornizës për monitorim

PLANI do të vlerësohet në çdo fund të vitit të zbatimit të tij. Vlerësimi do të fokusohet në pesë aspekte themelore, si:

- ✓ A kanë qenë të duhura aktivitetet e ndërmarra?
- ✓ Deri në çfarë mase janë arritur rezultatet e synuara?.
- ✓ Sa dhe si janë shfrytëzuar resurset njerëzore dhe financiare?
- ✓ Cilat janë ndryshimet e arritura si rezultat i ndërhyrjeve të realizuara?
- ✓ Sa do të jenë të qëndrueshme rezultatet dhe ndryshimet e arritura?